

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË LUSHNJË

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Viti 2025

Nr.Prot. 1	20.03.2025	Kërkuese.O.C Kërkohet informacion: : Në lidhje me paditë e marrdhënieve të punës punëmarrës (individ) punëdhënës (shteti/pushteti/qëndror/vendor. Së dyti: Sa çështje janë të fituara apo të humbura përballë shtetit për periudhën 2 vjeçare (2023-2025).	25.03.2025	Nga verifikimi në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS) për vitin 2023 rezultojnë 13 padi në kategorinë “Marrdhënie pune” për të cilat është disponuar si më poshtë: 6 pranim i pjesshëm, 2 rrëzim, 2 pushim, 2 pranim, 1 pezullim. Për vitin 2024 rezultojnë 25 padi me kategori ” Marrdhënie pune” për të cilat është disponuar si më poshtë: 3 Moskompetencë Lëndore, 8 pranim i pjesshëm, 4 pranim, 9 rrëzim 1 pushim Për vitin 2025 rezultojnë 7 padi me kategori ”Marrdhënie pune” për të cilat është disponuar si më poshtë: 4 pranim i pjesshëm 1 pranim, 1 Moskompetencë Lëndore 1 rrëzim.	E plotë	S’ka
---------------	------------	---	------------	--	------------	------

Nr.Prot 2	03.03.2025	Gazetare A. H kerkohet informacion : 1.<i>Se sa shtetas janë dënuar me “punë me interes publik” nga viti 2020-31.12.2024</i> 2. <i>Sa zyrtarë janë dënuar me “punë me interes publik nga gjykatat e posaçme të shkallës dhe apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar, nga viti 2020-31.12.2024.</i> 3.<i>Për cfarë veprash penale janë dënuar shtetasit shqiptarë (pika 1) dhe zyrtare (pika 2) ?</i>	04.03.2025	Në mbështetje të Ligjit Nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative” ju bejme me dije se Gjykata Administrative e Shkallë së Parë Lushnje nuk gjykon çështje të kësaj natyre.	E plotë	S”ka
--------------	------------	--	------------	--	---------	------

Nr.Prot 3	05.05.2025	Kërkuesë:M.C Kërkohet informacion: 1.Informacion për përbërjen e trupit gjykues në çështjen gjyqësore nr.**** nr.akti ***. 2.Informacion për vendimin e gjyqtarit z.E.T, për përbërjen e trupit gjykues, në mbështetje të parashtrimeve të paraqitura, dhe të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventes Europiane për të Drejtat e Njeriut.	12.05.2025	Mbështetur mbi Ligjin Nr.119 \ 2014 Për të Drejtën e Informimit ju bëjmë me dije se, nga verifikimet e kryera në sistemin e Menaxhimit të Çështjeve {ICMIS} për palët: Paditëse M.C palë e paditur: K i E, U .V , çështja është rregjistruar në datën 06.06.2023, dhe nga shorti elektronik i datës 06.06.2023 i kaloi gjyqtares Znj.E Sh. Në datën 02.11.2023 çështjet janë rishortuar sipas urdhërit Nr.1053 Prot datë 30.10.2023 të Zv/Kryetarit të Gjykatës, pasi gjyqtaria ka marrë lejen e barrë lindjes . Në datën 02.11.2023 dosja kaloi te gjyqtaria Znj.D.M. Në datën 23.04.2025 gjyqtare Znj.D.M ka bërë kërkesë Zv.Kryetarit të gjykatës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është pranuar më datë 02.05.2025. Në datën 08.05.2025 me vendim të Zv.Kryetarit të Gjykatës çështja i kaloi gjyqtarit z.H.B për shqyrtim.	E plotë	S”ka
--------------	------------	---	------------	---	---------	------

Nr.Prot.4	08.05.2025	Kërkojmë të na vini në dispozicion: Analizën Vjetore të Gjykatës për vitin 2024, Raportin Vjetor të zbatimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2024, Rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve 2024, Rregjistrin e realizimit të prokurimeve 2024.	22.05.2025	Në përgjigjë të shkresës suaj datë 08.05.2025, protokolluar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve me Nr.4/1 Prot., datë 08.05.2025, mbështetur mbi Ligjin Nr .119 \ 2014 Për të Drejtën e Informimit, bashkangjitur po ju vendosim në dispozicion: 1. Analizën Vjetore të Gjykatës për vitin 2024, 2. Raportin Vjetor të zbatimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2024, 3. Rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve 2024, 4. Rregjistrin e realizimit të prokurimeve 2024.	E plotë	S’ka
-----------	------------	---	------------	--	---------	------

Nr.Prot. 5	11.06.2025	Kërkohet informacion:Gazetare A.H 1- Sa është numri i çështjeve nën gjykim për të moshuarit që ju kanë humbur vitet e punës dhe që kanë hapur padi për pensionet? 2- Sa vendime u dhanë për 2024 për padi pensioni? 3- Statistika në lidhje me paditë për kompesim burgimi të padrejtë ? Sa janë aktualisht dhe sa kanë qenë vitin e kaluar?	16.06.2025	Referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë vijon: Numri i çështjeve nën gjykim për të moshuarit që ju kanë humbur vitet e punës dhe që kanë hapur padi për pensionet është 165. Sa i përket vendimet që u dhanë për 2024 për padi pensioni janë 456 vendime. Referuar pyetjes 3, padit për kompesim burgimi të padrejtë janë 16 padi në proçes, dhe për 15 padi janë dhënë vendime në vitin 2024.	E plotë	S’ka
---------------	------------	---	------------	--	---------	------

Nr.Prot 6	07.09.2025	Kërkohet informacion:F.T 1.Sa vendime janë disponuar gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për gjykime administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit dhe/ose Konventa e Aarhusit? 2.Çfarë kanë vendosur gjykatat për gjykimet administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor, ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit dhe/ose Konventa e Aarhusit? 3..Sa vendime janë disponuar gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për përshpejtimin e gjykimit për gjykime administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe/ose Konventa e Aarhusit? 4.Sa vendime pranimi dhe refuzimi janë disponuar nga gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për kërkesat për përshpejtimin e gjykimit në gjykimet administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor	18.09.2025	Në përgjigje të pikës parë ju bëjmë me dije se: Nga kërkimi ynë pas verifikimeve të kryera në Sistemin ICMIS, {Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve} për aq sa është e mundur të gjenerohen të dhëna të sakta, ka rezultuar se: Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, janë dhënë gjithsej, (3) vendime, si kërkesë-padi që lidhen me zbatimin e aktit normativ, për gjykime administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit dhe/ose Konventa e Aarhusit, në të cilën është vendosur rrëzim i kërkesë padisë.. Në përgjigje të pikës pesë ju bëjmë me dije se: Kohëzgjatja e gjykimeve të regjistruara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit dhe/ose Konventa e Aarhusit (në secilën nga shkallët e gjykimit kanë zgjatur mesatarisht 6 muaj. Sa i përket pyetjeve të tjera,ju bëjmë me dije se në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje nuk jane objekt gjykimi çështje të kësaj natyre.	E Plote	S'ka
-----------	------------	---	------------	--	---------	------

ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe/ose Konventa e Aarhusit?

5.Cila është kohëzgjatja e gjykimeve të regjistruara gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për gjykime administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit dhe/ose Konventa e Aarhusit (në secilën nga shkallët e gjykimit)?

6.Sa vendime janë disponuar gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për procedime penale lidhur me veprat penale kundër mjedisit (nenet 201 deri 207/ç të Kodit Penal)?

7.Çfarë kanë vendosur gjykatat për procedimet penale lidhur me veprat penale kundër mjedisit (nenet 201 deri 207/ç të Kodit Penal)?

8.Cila është kohëzgjatja e gjykimeve të regjistruara gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për procedime penale lidhur me veprat penale kundër mjedisit (nenet 201 deri 207/ç të Kodit Penal" (në secilën nga shkallët e gjykimit)?

Nr.Prot. 7	02.12.2025	<i>Kerkohet informacion F.T</i> <i>1.Cili është numri i çështjeve administrative të regjistruara dhe të pa shqyrtuara (backlog) deri në datën 31.10.2025 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje?</i> <i>2.Cili ishte numri i çështjeve administrative të regjistruara dhe të pa shqyrtuara (backlog) në datën 31.12.2024, 31.12.2023, 31.12.2022, 31.12.2021, 31.12.2020, 31.12.2019, 31.12.2018, 31.12.2017, 31.12.2016 në:</i> <i>-Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje (nga miratimi i hartës së re gjyqësore);</i> <i>-Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore,, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate?</i> <i>3.Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet administrative të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate, të ndryshuara nga Gjykata Administrative e Apelit, në vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 01.012025- 31.10,2025?</i>	22.12.2025	Kërkesa juaj datë 02.12.2025 dërguar në adresën zyrtare të e-mailit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, dhe rregjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 7, si dhe me nr prot.9159, datë 02.12.2025 në të cilën kërkon informacion që mbështetet në parashikimet e Ligjit Nr.119\2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ku kërkon informacion lidhur me pyetjet e mëposhtme. <i>1.Cili është numri i çështjeve administrative të regjistruara dhe të pa shqyrtuara (backlog) deri në datën 31.10.2025 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje?</i> Për sa më sipër, numri i çështjeve administrative të regjistruara dhe të pa shqyrtuara (backlog) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje deri në datën 30.09.2025 referuar statistikes së fundit janë 1638 çështje, të cilat janë në gjykim. <i>2.Cili ishte numri i çështjeve administrative të regjistruara dhe të pa shqyrtuara (backlog) në datën 31.12.2024, 31.12.2023, 31.12.2022, 31.12.2021, 31.12.2020, 31.12.2019, 31.12.2018, 31.12.2017, 31.12.2016 në:</i> <i>-Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje (nga miratimi i hartës së re gjyqësore);</i> <i>-Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore,, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate?</i>	E plotë	S’ka
---------------	------------	---	------------	--	---------	------

	4.Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet administrative të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate, të prishura dhe të dërguara për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit, në vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 01.01.2025-31.10.2025? 5.Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet administrative të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate, të lëna në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 01.01.2025-31.10.2025? 6.Cili është numri mesatar i vendimeve të disponuara për çështjet administrative në vitet 2016,2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025-31.10.2025, nga gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje (nga miratimi i hartës së re gjyqësore) Gjykatave Administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat janë në kompetencën e kësaj gjykate.	Referuar pyetjes së mesipërme, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë rezulton se, gjatë vitit 2023 <u>janë regjistruar</u> në Total 3990 çështje, nga të cilat çështje të mbartura nga viti 2022 kanë qënë 1468 çështje, ndërsa numri i çështjeve të reja të regjistruara është 3029 çështje, nga të cilat 1965 janë çështje themeli dhe 1064 kërkesa të veçanta dhe urdhëra ekzekutimi. Numri i çështjeve administrative <u>të gjykuara</u> nga kjo gjykatë për vitin 2023, ka qënë në total 2216 çështje, nga të cilat gjykime themeli 1190 çështje; të veçanta dhe urdhëra ekzekutimi gjithsej 1026 çështje. Përsa i përket vitit 2024 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje çështje të rregjistruara janë 2561 dhe të pa shqyrtuara(backlog) 1750. Përsa i përket ish Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër numri i çështjeve të rregjistruara për vitin 2016 është 856 çështje.Viti 2017 janë 2264 çështje, në vitin 2018 janë 2355 çështje, viti 2019 çështje të rregjistruara janë 1825 çështje, viti 2020 janë 1113 çështje,viti 2021 janë 987 çështje, viti 2022 janë 1580 çështje, viti 2023 janë 559 deri në 30.06.2023 çështje, pasi u be dhe ndarja e hartës së re gjyqësore. 3.Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet administrative të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate, të ndryshuara nga Gjykata Administrative e Apelit, në vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 01.012025- 31.10,2025?	E plotë	S'ka
--	--	--	---------	------

	7.Cili ka qënë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të miratuar në vitet 2016,2017,2018,2019,2020,2021,2022,2023,2024,01.01.2025-31.10.2025 në organikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatave Administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat janë në kompetencën e kësaj gjykate? 8.Cili ka qënë numri i vakancave në vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, -31.10.2025, në organikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatave Administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat janë në kompetencën e kësaj gjykate.		Referuar pyetjes së mësipërme ju informojmë se numri çështjeve të mbartura nga ish gjykatat ka qënë 1468 çështje (referuar Analizës Vjetore 2023) 4.Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet administrative të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate, të prishura dhe të dërguara për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit, në vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 01.01.2025- 31.10.2025? 5.Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet administrative të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatat e tjera administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat kanë kaluar në kompetencën e kësaj gjykate, të lëna në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 01.01.2025-31.10.2025? Për sa më sipër referuar, pyetjes katër dhe pesë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë nga vitet 2016-30.06.2023 janë dhënë 12562 vendime, lënie në fuqi kanë qënë 1943 ,moskompetencë nga gjykatat e tjera janë 367 çështje, dhe çështje të rikthyera për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit 713 çështje.Referuar përqindjeve të vendimeve gjykata nuk ka informacion statistikor për këto të dhëna	E plotë	S'ka
--	---	--	---	---------	------

			<i>6.Cili është numri mesatar i vendimeve të disponuara për çështjet administrative në vitet 2016,2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025-31.10.2025, nga gjyqtarët e :Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje (nga miratimi i hartës së re gjyqësore)Gjykatave Administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat janë në kompetencën e kësaj gjykate.</i> Numri mesatar i vendimeve për çështjet administrative për vitin 2023 është 2216 çështje të përfunduara.Për vitin 2024 numri i vendimeve për çështjet administrative është 2585 çështje të përfunduara.Për vitin 2025 referuar satatistikës shtator 2025 janë dhënë 1739 vendime. <i>7.Cili ka qënë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të miratuar në vitet 2016,2017,2018,2019,2020,2021,2022,2023,2024,01.01.2025-31.10.2025 në organikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatave Administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat janë në kompetencën e kësaj gjykate?</i> Referuar pyetjes së mësipërmë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të miratuar për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje ka qënë 9 gjyqtarë për vitet 2023-2025. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të miratuar e ka pas 4 gjyqtarë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të miratuar e ka pas 4 gjyqtarë. <i>8.Cili ka qënë numri i vakancave në vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, -31.10.2025, në organikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykatave Administrative përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, të cilat janë në kompetencën e kësaj gjykate.</i>	E plotë	S’ka
--	--	--	--	---------	------

				Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, është gjykata më e re, e krijuar si rrjedhojë e zbatimit të hartës së re gjyqësore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, është bashkim i gjykatave administrative të shkallës së parë Vlorë dhe Gjirokastrë, me kompetencë territoriale Qarqet Gjirokastrë, Vlorë, Fier dhe Berat. Gjykata ka nisur rrugëtimin e saj më datë 03.07.2023, me vetëm 5(pesë) gjyqtarë, të ardhur nga trupat gjykuese të ish Gjykatave Administrative Gjirokastrë dhe Vlorë. Organika e saj parashikon 9 Gjyqtarë, ndërkohë që gjatë vitit 2023 kanë ushtruar detyrën efektivisht mesatarisht 5 gjyqtar për periudhën deri korrik 2023, dhe nga korriku 2023 e ne vijim 6 gjyqtarë për shkak të ndryshimeve në trupën gjykuese. Pra, gjatë vitit 2023 deri në muajin Qershor, kanë ushtruar detyrën 6 gjyqtarë. Përkatësisht (tre gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe dy gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Përsa i përket vitit 2024 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë kanë ushtruar detyrën 6 gjyqtarë, dhe nga Tetor-Dhjetor 2024 kanë ushtruar detyrën 7 gjyqtarë që ka qënë organika. Për vitin 2025 ka vazhduar me 6 gjyqtarë por kemi pas transferime të gjyqtarëve në gjykata tjera, por aktualisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje e ka plotësuar organikën e saj me 9 gjyqtarë. Për sa më sipër ju bëjmë me dije se, numri i vakancave në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë për vitin 2016-2019 në organikë kanë qënë 4 gjyqtarë por faktik që kanë ushtruar funksionin kanë qënë 2 gjyqtarë. Në vitin 2020 nuk k Në vitin 2021 kanë qënë 3 gjyqtarë , më pas ka pas transferime dhe në fund të vitit, faktik që kan ushtruar detyrën ka qënë 1 gjyqtarë dhe ka vazhduar me nje gjyqtarë dhe viti 2022. Në vitin 2023 kanë ushtruar funksionin e tyre 2 gjyqtarë deri sa u bë dhe ndarja e re e hartës gjyqësore.		
--	--	--	--	---	--	--

				Përsa i përket ish Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë numri i vakancave të gjyqtarëve në organikën për vitet e mësipërme ka qënë 2014-2017 ka pas një gjyqtarë por faktik që kanë ushtruar funksionin kanë qënë 3 gjyqtarë. Për vitin 2017-2020 nuk ka pas vakanca pasi kanë ushtruar funksionin 4 gjyqtarë.Në vitin 2020-30.06.2023 ka pas një vakancë dhe kanë ushtruar funksionin 3 gjyqtarë pasi u be dhe ndarja e hartës së re gjyqësore.		
--	--	--	--	---	--	--

Nr.Prot 8	02.12.2025	Kërkohet informacion K D 1.A ka pasur praktika nga gjykatat lidhur me çështje të ngacmimit seksual dhe dhunës në vendin e punës, gjatë dhjetë viteve të fundit? 2. Nëse ka pasur praktika të tilla, kërkohet vendosja në dispozicion e kopjeve të vendimeve gjyqësore që kanë disponuar në lidhje me këtë çështje.	04.12.2025	Kërkesa juaj datë 20.11.2025 dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është përcjellë për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe rregjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 8, si dhe me nr prot.9146 datë 02.12.2025, në të cilën kërkonti informacion që mbështetet në parashikimet e Ligjit Nr.119\2014 Për të Drejtën e Informimit”, ku kërkonti informacion lidhur me pyetjet e mëposhtme. 1- A ka pasur praktika nga gjykatat lidhur me çështje të ngacmimit seksual dhe dhunës në vendin e punës, gjatë dhjetë viteve të fundit? 2- Nëse ka pasur praktika të tilla, kërkohet vendosja në dispozicion e kopjeve të vendimeve gjyqësore që kanë disponuar në lidhje me këtë çështje. Në lidhje me kërkesat tuaja sa më sipër, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje , si dhe ish Gjykata e rrethit Gjirokastër dhe Vlorës nuk ka pas çështje të tilla.	E plotë	S”ka
-----------	------------	---	------------	--	---------	------

--	--	--	--	--	--	--

Nr.Prot 9	09.12.2025	<i>1.Sa është numri i rasteve të gjykuara nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Lushnjë, ku palë e paditur është Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve, për kundërshtimin të masave apo dhe gjobave të vendosur nga Agjencia ndaj subjekteve tregtare për mos instalimin impiante private të trajtimit të ujërave të ndotura, per vitet 2024-2025?</i> <i>2.Sa është numri i rasteve nën gjykim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, ku palë e paditur është Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve, për kundërshtimin të masave apo dhe gjobave të vendosur nga Agjencia ndaj subjekteve tregtare për mos instalimin impiante private të trajtimit të ujërave të ndotura, për vitet 2024-2025?</i>	18.12.2025	Kërkesa juaj datë 09.12.2025 dërguar në adresën zyrtare të e-mailit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, dhe rregjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 9, si dhe me nr prot.9311 datë 09.12.2025 në të cilën kërkon informacion që mbështetet në parashikimet e Ligjit Nr.119\2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ku kërkon informacion lidhur me pyetjet e mëposhtme. <i>1.Sa është numri i rasteve të gjykuara nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Lushnjë, ku palë e paditur është Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve, për kundërshtimin të masave apo dhe gjobave të vendosur nga Agjencia ndaj subjekteve tregtare për mos instalimin impiante private të trajtimit të ujërave të ndotura, per vitet 2024-2025?</i> Referuar pyetjes së mësipërme, ju bëjmë me dije se: Pas verifikimeve të kryera në Sistemin ICMIS, {Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve} rezulton se: Numri i rasteve të gjykuara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, ku palë e paditur është Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve, dhe objekt për kundërshtimin e masave apo dhe gjobave të vendosur nga Agjencia ndaj subjekteve tregtare për mos instalimin impianteve private të trajtimit të ujërave të ndotura, për vitet 2024-2025, numri i çështjeve të vendimuara dhe që i ka përfunduar gjykimi janë 8 çështje. <i>2.Sa është numri i rasteve nën gjykim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, ku palë e paditur është Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve, për kundërshtimin të masave apo dhe gjobave të vendosur nga Agjencia ndaj subjekteve tregtare për mos instalimin impiante private të trajtimit të ujërave të ndotura, për vitet 2024-2025?</i>	E plotë	S”ka
-----------	------------	--	------------	--	---------	------

				Në përgjigje të pyetjes së dyte, ju bëjme me dije se: Pas verifikimeve të kryera në Sistemin ICMIS, {Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve} për aq sa është e mundur të gjenerohen të dhëna numri i çështjeve nën gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, ku palë e paditur është Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, për kundështimin të masave apo dhe gjobave të vendosur nga Agjencia ndaj subjekteve tregtare për mos instalimin impiante private të trajtimit të ujërave të ndotura, për vitet 2024-2025 janë 13 çështje që po gjykohen pranë kësaj gjykate <i>3- Ju lutem, na vendosni në dispozicion vendimin e gjykimit të rasteve.</i> Bashkangjitur gjeni 8 vendime të anonimizuara.		
--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--

